DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesionali operatorëve ekonomikë:

Sipas Kritereve të përgjithshme për kualifikim.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të certifikuar të bilancit, të viteve 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse, sipas ligjit nr. 10091 datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesi Vërtetim të xhiros vjetore për vitet 2017, 2018, 2019, e cila duhet të ketë një xhiro mesatare sa 50% e fondit limit.

c. Operatori ekonomik duhet të paraqesi një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet tatimore të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet. Kësaj deklarate duhet të bashkalidhen të gjitha vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik i ka paguar të gjitha detyrimet tatimore. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të vërtetojë vërtetimin e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të veproj në përputhje me nenin 13, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar.

2.3 Per kapacitetin teknik:

1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 35% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave, **ose**

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.3/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

a. Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqesë/in dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve
- Kontraten/at e Siper marrjes
- Situacionin përfundimtar te objektit;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim.

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve
- Kontraten/at e Siper marrjes
- Situacionin përfundimtar te objektit;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/aktin e perdorimit.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

i) Ne rast se kontrata e ngjashme e paraqitur eshte realizuar si nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon:

- Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor
- Dokumentacioni i kerkuar ne pikat i) ose ii) sipas rastit

2. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te disponojne licensa profesionale te shoqerise per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licencen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

- a. Kategoria NP – 1 D (Punime germimi ne toke)
- b. Kategoria NP – 2 C (Ndertime civile dhe industriale)
- c. Kategoria NP – 4 B (Rruge, Autostrada, Mbikalime, Hekurudha, Tramvaj, Metro, Pista Aeroportuale)
- d. Kategoria NP – 5 B (Punime nentokesore, Ura dhe Vepra arti)
- e. Kategoria NP – 7 G (Ujesjellesa, Gazsjellesa, Vajsjellesa, Vepra kullimi dhe vaditje)
- f. Kategoria NP – 12 D (Punime te Inxhinierise te Mjedisit)
- g. Kategoria NS – 2 C (Impiante hidrosanitare)

Dokumenta Standarde të Tenderit

- h. Kategoria NS – 4 B (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to)
- i. Kategoria NS – 9 C (Punime strukturore speciale)
- j. Kategoria NS – 14 C (Impiante te brendeshme)
- k. Kategoria NS – 16 C (Ndertimi i impianteve te ujite te pijshem dhe pastrimit te tij)
- l. Kategoria NS – 18 C (Punime topogjeodezike)
- m. Kategoria NS – 20 C (Shpime Gjeologo inxhinierike)

3. Operatoret ekonomik pjesmarrës duhet të dëshmoj me ane te nje deklarate se ka staf teknik si mëposhtme:

- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi
- 1(nje) inxhinier mjedise te jete i pajisur me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1(nje) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1(nje) inxhinier mekanik
- 1 (nje) inxhinier elektrik

Per secilin prej pjestareve drejtues te stafit teknik duhet te paraqitet :

- kontrate noteriale pune te vlefshme
 - diploma ose kualifikimin perkates ku deshmia e kualifikimit ose diploma te jete e leshuar nga institucionete e licensuara/akredituara shteterore
- Krahas stafit te mesiperm duhet te kete te punesuar si staf mbeshtetes personelin si me poshte:
- 1(nje) inxhinier hidroteknik
 - 2(dy) inxhinier topograf
 - 2 (dy)inxhinier ndertimi
 - 1(nje) inxhinier gjeolog
 - 1(nje) inxhinier mjedisi

Operatori ekonomik te paraqes per stafin e mesiperm kontrata noteriale te punes , diploma ose kualifikimin perkates per secilin punonjes ku deshmia e kualifikimit ose diploma te jete e leshuar nga institucionete e licensuara/akredituara shteterore

Deklarata e stafit te shoqerohet me kontraten e punes dhe diplomen per secilin prej tyre, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per nje periudhe 12 mujore(janar-dhjetor 2020),.

1. Operatori/et ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te deklaroje se stafi teknik dhe punonjesit e kerkuar qe do te angazhohen sipas kritereve te kerkuara te “Kapacitetit teknik” nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera dhe se bashku me deklaraten e OE te paraqitet dhe vetdeklarate personale nga drejtuesi teknik i OE e cila do te shoqeroj deklaraten e subjektit .
2. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te kete ne stafin e punonjesve **jo me pak se 35 (tridhjetë e pesë)** punonjes te pajisur me deshmi kualifikimi te vlefshme te sigurimit teknik nga institucionet e akredituara sipas legjislacionit ne fuqi, ku nga keta te jene te pakten

Dokumenta Standarde të Tenderit

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Teknik ndertimi – | 4 (kater) punonjes |
| 2. Hekurkthyes – | 6 (gjashte) punonjes |
| 3. Karperntier – | 4 (kater) punonjes |
| 4. Muratore – | 3(tre) punonjes |
| 5. Elektriciste – | 3 (tre) punonjes |
| 6. Mekanike – | 3 (tre) punonjes |
| 7. Saldatore - | 2 (dy) punonjes |
| 8. Hidraulike – | 10(dhjete) punonjes |

2/1 Operatori ekonomik duhet te kete pjese te stafit te tij jo me pak se 15 shofere dhe jo me pak se 15 manovrator te pajisur me deshmi kualifikim te sigurimit teknik, dhe leje drejtimit

Shofer-	15 (pesembedhjete) punonjes
Manovrator	15 (pesembedhjete) punonjes

3. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) mjek ne baze te ligjit nr.10237 date 18.02.2010, VKM nr108 date 09.02.2011 i ndryshuar me VKM nr.632 dt , 15,07,2015 ,ose mardhenie kontraktore me subjekte te specializuara per kete qellim.ne rastinkur pjese te stafit ka nje mjek duhet te paraqese kontraten noteriale te punes, diplomen, licencen e leshuar nga urdhri i mjekut. Ne rastin e mardhenieve kontraktore me subjekt te specializuar duhet te paraqes kontrate noteriale te vlefshme.
Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, ky kriter plotesohet nga i gjithë bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemartjes ne pune, te percaktuara ne marreveshjen e bashkepunimit sipas VKM nr108 date 09.02.2011 i ndryshuar me VKM nr.632 dt , 15,07,2015 .
4. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te kete ne stafin e tij personel te kualifikuar / certifikuar si:
- 1 (nje) eksperte zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te ligjit 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin", me objekt pune per "Hartimin e akteve te ekspertizes per zjarret e rena", certifikuar nga Drejtoria e MZSH, prane Ministrise se Brendshme
 - 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akredituese te njohura, ne perputhje me ligjin nr.10327 date 18.02.2010 dhe VKM nr.312 date 05.05.2010.
 - 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave" e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akredituese te njohura.
 - 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate "Koordinator per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akredituese te njohura, ne perputhje me ligjin nr.10327 date 18.02.2010 dhe VKM nr.312 date 05.05.2010.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Per te provuar disponueshmerine e ketij stafi duhet te paraqese listpagesen e punonjesve te 12 muajve te fundit(janar-dhjetor 2020), te shoqeruar me kontratat e punes dhe diplomat / certifikatat perkatese.

5. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te kete nje punesim mesatar i te pakten 400 punonjes(perfshire stafi teknik dhe gjithë fuqin puntore, ekspert etj si mesiperm) me kohe te plote pune *per periudhen 12 muajt e fundit (janar - dhjetor 2020)*, per te cilet duhet te paraqesi dokumentacion si me poshte:

- Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ose Sigurimet Shoqerore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj.
- Listepagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, te shoqeruar me formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqerore dhe shendetesore .

6. Operatori/et ekonomike ofertues duhet te jete i certifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur, si me poshte:

- Certifikate cilesie sipas standartit BS EN 13331-1:2002 (Per sistemet per veshjen e kanaleve), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim
- Certifikate cilesie sipas standartit ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit mjedisor), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim
- Certifikate cilesie sipas standartit ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit te sigurise se trafikut rrugor), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim
- Certifikate cilesie sipas standartit ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim,
- Certifikate cilesie sipas standartit OHSAS 18001-2007/ 2013N Ose SSH ISO 45001-2018 (Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim
- Certifikate cilesie sipas standartit DS CENT/TR 15128:2005 (Per shqyrtimin e standarteve europiane per riparimin e sistemeve te kanalizimit dhe kullimit), ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim
- Certifikate cilesie mbi Kerkesat e cilesise per saldim me shkrirje te materialeve metalike ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalentet duhet te jene te leshuara nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojne keto certifikata ne perputhje me punimet qe ka marre persiper te kryeje .

7. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Mjetet	Njesia	Sasia	Gjendja
--------	--------	-------	---------

Dokumenta Standarde të Tenderit

Autovinc	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Kamiona veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-20 ton	Cope	3	Ne pronesi ose me qera
Kamiona veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Cope	7	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3 - 3,5 ton	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 2 ton	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Autobot nafte	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Autopompe betoni	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Motogjenerator/gjenerator	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Fadrome me goma me kove para dhe mbrapa	Cope	3	Ne pronesi ose me qera
Mini fadrome	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	Cope	5	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me krahe te gjate mbi 15 m	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Buldozer	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Kompresor ajri	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Saldatrice / motosaldatrice	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Sharre per prerje asfalti	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Aparat saldimi tubacionesh elektrofuzion HDPE, PVC	Cope	3	Ne pronesi ose me qera
Fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore	Cope	1	Ne pronesi / me qera / kontrate furnizimi
Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore	Cope	1	Ne pronesi / me qera / kontrate furnizimi
Nyje inerte e pajisur me leje mjedisore	Cope	1	Ne pronesi / me qera / kontrate furnizimi
Terheqes	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Asfaltoshtruese	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Autobitumatrice	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Greider	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Rimorkiator	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Freze asfalti	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Kompaktor njgjeshes	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Matrapik	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Tranxhe	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Sistem ëell point	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Eskavator trencher per punime specifike	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Rul ngjeshes deri ne 9-12 (gome- cilinder hekuri)	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Rul ngjeshes deri ne 9-12 (cylinder - cilinder)	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
Zyre kantieri e levizshme	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Autovetura kantieri	Cope	3	Ne pronesi ose me qera

- I.Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur jane ne pronesi duhet të paraqitet:
- a) dokumenti që verteton regjistrimin/pronesin e mjetit(certifikaten e pronesise).
- b)leje qarkullimi;
- c)certifikaten e kontrollit teknik;

Dokumenta Standarde të Tenderit

- d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
 - e) çertifikatën për transport mallrash (leje transporti e vlefshme).
 -
 - **Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet.**
 - a) dokumenti që verteton regjistrimin/pronesin e mjetit (certifikatën e pronësive).
 - b) leje qarkullimi;
 - c) çertifikatën e kontrollit teknik;
 - d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
 - e) çertifikatën për transport mallrash (leje transporti e vlefshme sipas parasghikimeve të Kodit Rrugor për përdorim nga të tretë dhe leja e transportit të jete e leshuar për këtë qëllim).
 - g) kontratën përkatëse materiale të qerave/furnizimit .
-
- II. Në rastin e mjeteve të tjera që nuk shënohen në regjistrat publik kur janë në pronësi duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo aktet e ç'doganimit faturat tatimore të blerjes dhe foto, ndërsa për mjete të marra me qera krahas kësaj dokumentacioni (kontrata e blerjes apo aktet e ç'doganimit faturat tatimore të blerjes dhe foto) duhet dhe kontrata materiale të qerave/furnizimit.
 - Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
 - Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor Autoriteti deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.10.
 - Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura do të jenë të angazhuara në kontratë. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të paraqesi mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 200 (dyqind) copë;
- Jelek minimum 200 (dyqind) cope
- Prozhektorë ndricimi natën minimumi 6 (gjashtë) copë;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 7 (shtatë) copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 (tridhjetë) copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet mbi 5 litra secila minimumi 10 (dhjetë) cope

III. Për fabrikën e betonit , asfaltit , bitumit dhe nyjen e inerteve në rast se OE nuk është prodhues kërkohej një vetedeklarim nga OE ofertues që në këtë rast , prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësive dhe të rezervave të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fituesi, AK kërkonë paraqitjen e certifikatës në fjalë.

Dokumenta Standarde të Tenderit

IV. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar, dhe për këto duhet deklarate me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese mbi vendodhjen e mjeteve .

V. Administratori i shoqërisë ofertuese duhet të paraqesë dhe një deklaratë me shkrim se merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesë pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara si më sipër në rast se do lind nevoja për verifikimin e tyre përpara shpalljes së klasifikimit .

VI. Administratori i shoqërisë ofertuese duhet të paraqesë dhe një deklaratë se informacioni dhe dokumentat e paraqitura në tender janë të sakta dhe nuk përmbajnë informacion të rreme për penalizim conform nenit 13 të LPP

VII. Administratori i shoqërisë ofertuese duhet të paraqesë dhe një deklaratë se makineritë e mesipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor .

VIII. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë notoriale me një laborator testimi të betonit i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standardeve SSHEN12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.

IX Operatori Ekonomik duhet të paraqesë bashkë me preventivin edhe analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertes. Mosparaqitja në formën e kërkuar përben kusht për skualifikim .

X Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarim se brenda të njëjtes periudhe nuk është kontraktor /nenkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues me vlerë të përbashkët ose të veçantë , me të madhe se 100 % i kufirit maksimal , që disponon kandidati sipas licenses profesionale të leshuar nga autoritete kompetente . Në kuptim të përcaktimit të mesipërme , fjala periudhe nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-se nga casti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit /investimit (shtojca 11). Në rastin e BOE ky kusht plotësohet nga çdo operator pjesëmarrës.

XI. Vetdeklarim nga operatori ekonomik pjesëmarrës për kontratat që ka në proces dhe/ose është shpallur fitues duke përcaktuar objektin, vlerën e kontratës si dhe drejtuesin teknik të deklaruar për secilin objekt që ka në proces dhe /ose është shpallur fitues . Në rastin e B.O.E , secili prej antareve të bashkimit duhet të plotësojë këto deklarate.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: Bashkelidhur sipas dokumentave të tenderit të ngarkuara në sistem.

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur sipas dokumentave të tenderit të ngarkuara në sistem.

Grafiku i Punimeve: Bashkelidhur sipas dokumentave të tenderit të ngarkuara në sistem.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkelidhur sipas dokumentave të tenderit të ngarkuara në sistem.

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkelidhur sipas dokumentave të tenderit të ngarkuara në sistem

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
<Emri>

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon në objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
